



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 25/05/2026 Ora : 12 / :00 Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 25 banorë

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

**PËR MIRATIMIN E HARTAVE PER MENAXHIMIN E HAPESIRAVE PUBLIKE
SIPAS RREGULLORES NR 24, DATE 01.04.2026.**

Pjesëmarrës :

Klea Topa (Këshilltare)

Vjollca Pllaha (Këshilltare)

Klajdi Gjona (Këshilltar)

Anila Gjoshe (Këshilltare)

Mimoza Shuli (Këshilltare)

Arbër Male (Këshilltar)

Jona Bojko (Sekretare Këshilli)

Suela Mertkola (Punonjëse Sekretarjati)

Znj. Topa: Përshëndetje, nga institucioni i Bashkisë ka ardhur një projekt-vendim për hapësirat publike dhe për këtë arsye jemi mbledhur sot për të diskutuar dhe për të marrë mendimet tuaja. Jeni të lirë për të ngritur çdo problematikë, ndërsa ne jemi këtu për t'ju dëgjuar dhe diskutuar së bashku.

Znj.Karafili : Përshëndetje dhe ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj. Me V.K.M.-në e re në lidhje me hapësirat publike kanë ndryshuar shumë rregulla. Të gjithë jeni informuar me anë të një njoftimi për dokumentat që duhen për hapësirat publike.

Z. D.Hoxha: Do t'ju kërkoja vetëm një gjë. Nuk mund të na lajmëroni në momentet e fundit, sepse ne nuk kemi lexuar as V.K.M.-në dhe nuk jemi të informuar se për çfarë diskutohet.

Znj.Karafili : Çdo kush nga ju është lajmëruar në faqen zyrtare dhe V.K.M.-në e keni të skanuar dhe të publikuar. Ne kemi respektuar afatin ligjor të njoftimit për konsultim public.

Por më e rëndësishme është harta që do të miratojmë sepse I jep më shumë përparësi këmbësorëve. Në rastet kur trotuari është 2 m I gjerë I jepet përparësi këmbësorëve, nuk lejohen tavolina.

Kusht tjetër është që projekti duhet të jetë I hartuar nga një arkitekt, ku ju duhet të merrni një arkitekt të licencuar për marrjen e lejes. Lejet nuk do të bëhen më nga arkitektët e Bashkisë, pasi konsiderohet konflikt interesi.

Pjesa tjetër që doja të diskutoja me ju është që për cdo tavolinë që nxirrni duhet të mbillni një pemë në një vend që do të caktohet nga Bashkia, kjo është një gjë në të mirë të komunitetit.

Nuk lejohet kategorikisht pedana në trotuar, vetëm në zona që kalsifikohen si të degraduara. Këtë vit do të vazhdojmë me shfrytëzimin e lulishtes, vetëm që nuk lejohen pedanat, dhe pse po mundohemi shumë që të paktën të marrim aprovimin për të vendosur pedana. Në fakt do të doja që kjo rregullore të na prezantohej para se të miratohej por jemi përpara faktit.

Kjo V.K.M. lejon tendat, por pa këmbë. Nuk lejohen vazot, por vetëm tavolina me katër karrige. Gjithashtu, edhe bizneset që shesin fruta-perime do të duhet të bëjnë rafte me kate për vendosjen e mallrave të tyre. Nuk do të lejohet më që çdo biznes të reklamojë diçka të vogël dhe të nxjerrë të gjithë mallin jashtë. Tek Rruga "Rinia", pranë rreth-rrotullimit ku ndodhen disa subjekte me fruta-perime, nuk lejohen të nxirren karrige. Nëse keni diskutime, mund të diskutojmë çdo problematikë.

Z.Hoxha: Do të dëshiroja që kjo rregullore të dërgohej para se të miratohej.

Z.Hoxha : Në momentin që është miratuar, ne nuk kemi më çfarë të bëjmë.

Znj.Karafili: Le të ndalemi tek një pikë konkrete: çfarë mund të rregullojmë dhe çfarë kërkoni ju më tepër?

Z.Hoxha : Ne gjithmonë kemi qenë korrektë dhe edhe në momentin kur kemi hequr pedanat, i kemi kthyer në gjendjen e mëparshme. Nuk na kushton të mbjellim një pemë, në momentin që është në të mirën e qytetit.

Z. Mato: Pjesë e degraduar mund të quhet edhe pjesa e barit që shkelet. Për sa i përket pemëve që do të mbillen, a do të ketë ndryshim në tarifa?

Znj.Karafili : Nuk do të bëhet çdo vit mbjellja e pemëve. Do të bëhet vetëm këtë vit dhe, në rast se vitin tjetër do të shtoni tavolina, do të mbillni pemë vetëm për tavolinat shtesë.

Z. Kolvani: Më falni, kaç keq ka ngelur Bashkia sa të na bëjë të paguajmë edhe pemët? Pjesa tjetër që më shqetëson është pse duhet të paguajmë edhe arkitektin.

Znj.Karafili: V.K.M.-ja nuk na lejon më ta bëjmë ne këtë procedurë.

Z. Kolvani: Duhet të ishte edhe Kryetari këtu. Gjithashtu, një tjetër shqetësim është pse kioskat sezonale gjatë shëtitorës duhet të na konkurrojnë duke shitur hamburgera dhe ushqime të tjera.

Znj.Karafili: Keni shumë të drejtë. Kjo V.K.M. nuk e lejon më këtë pjesë.

Znj. Shuli: Ato janë ideuar për të ndihmuar gratë në nevojë.

Znj.Karafili:: Janë vendosur për të hequr tezgat dhe për të rregulluar pamjen e shëtitorës.

Z. Rusi: Ato nuk janë aspak higjienike.

Znj.Karafili: Pasi të mbarojë diskutimi me ju, i kam thirrur veçmas për ta diskutuar, pasi ata janë më pak në numër.

Z. Kolvani: Ju lutem të diskutohet pjesa e arkitektit.

Znj.Karafili: Kjo pjesë nuk diskutohet, pasi ka ardhur me V.K.M.

Z. Altin: Arkitektët kërkojnë deri në 500 mijë lekë, që është shumë.

Znj.Karafili:: Ju keni paguar vetëm deklaratën paraprake, nuk ka lidhje me këtë pjesë.

Z. Kolvani: Le ta bëjnë inxhinierët e Bashkisë.

Znj.Karafili:: Është konflikt interesi. Kryetari, që të japë lejen, duhet të ketë dokumentacion të saktë.

Z. Hoxha : Mund të flasim për pedanat, sepse po të bëjmë një llogari nga fillimi deri në fund të xhiros, nëse nuk vendosen, ne do të detyrohemi të heqim personelin, ku bëhen afërsisht 100 veta që mbeten pa punë. Ne jemi korrektë dhe gjithmonë kemi respektuar ato që janë kërkuar. Duhet të ishte edhe Kryetari këtu.

Znj.Karafili: Unë do t'ia delegoj të gjitha Kryetarit, por të jeni të sigurt që ai po bën të pamundurën. Unë vetë kam qenë gjithmonë pro pedanave.

Z.Hoxha : Ne marrim përsipër që çdo gjë të jetë estetikisht e bukur dhe të ketë një shërbim të kualifikuar.

Znj. Topa: Të jeni të sigurt që edhe Kryetari, edhe ne si Këshill, jemi gjithmonë pro bizneseve dhe gjithashtu edhe pro pedanave.

Znj.Karafili: Ne presim përgjigjen dhe jam optimiste që do të kemi një përgjigje pozitive.

Z. Rusi: Por kjo do të zgjasë, ndërsa pedanat duan kohë.

Z.Hoxha: Problemi ynë është edhe tek punëtorët.

Znj.Karafili: Ju siguroj që, sapo të mbarojmë sot, do ta zbardhim procesverbalin dhe do e dërgojmë kërkesën për miratim.

Znj. Hymeti: A mund të kem një sqarim për ne bizneset që jemi në qytet, si do të funksionojmë?

Znj.Karafili: Për ju është e lejueshme deri në 10 metra.

Z. Hymeti: Të ketë një mesatare.

Znj.Karafili: Gjatë gjithë vitit qyteti punon.

Z. Hymeti: Kush e thotë këtë?

Znj.Karafili: Ne po shohim mundësinë për t'i lejuar pedanat. Është çështje vetëm e një muaji.

Z. Dulellari: Meqë do të mbjellim pemë, a mund të ulim çmimin e pagesës për pedanat? Gjithashtu, a mund të na jepni një lejë 5-vjeçare?

Znj.Karafili: Mund të japim një lejë 5-vjeçare vetëm me vendim Këshilli. Duhet të miratohet njëherë leja 1-vjeçare dhe më pas do të kalojë në Këshill çdo subjekt, një për një, për të marrë lejën për 5 vite.

Administratori për lodrat e fëmijëve: Meqë do të bëhet "Lungo Gjoli", a mund ta dime kur do të fillojë, që të mos na ndodhë në mes të punës?

Znj. Shuli: Doja të ndërhyja për pemët që do të mbjellim, që të përcaktohen.

Z. Likollari: Pemët do t'i mbjellë çdo subjekt.

E.Karafili: Po do I mbjellë cdo subject që do të nxjerë tavolina.

Z. Tani: Nuk është problem mbjellja e pemëve, por të diskutohet pjesa e pedanave.

Znj. Enjela: Më të rëndësishme janë hartat dhe dërgimi i shkresave në Tiranë për të marrë aprovimin.

Z. Kolvani: Si do të bëhet pjesa e pagesës?

Znj. Enjela: Të bëhet njëherë konstatimi.

Z. Kolvani: Si mund t'i shmangim?

Znj. Enjela: Sa metër katror?

Z. Babasuli: Nuk aplikon dot Bashkia, aplikimet i bëni vetë ju.

Z. Amarildo: Ne që nuk kemi as trotuare, por vetëm sheshe, a mund të lejohet?

Znj. Enjela: Në sheshe lejohet më shumë. Çdo kërkesë që është bërë, projekti duhet të vijë nga arkitekti. Vitin e kaluar nuk është paguar asnjë lek.

Z. Babasuli: Këtë vit nuk mund të bëhet më në këtë mënyrë aplikimi.

Znj. Enjela: Do të merret leja 1-vjeçare. Kur të konstatohet që ju nuk keni shkelje, atëherë keni të drejtë për leje 5-vjeçare. Edhe për fruta-perime duhet të bëhen me kate: 1.80 m pa mbështetje dhe 1 m me mbështetje.

Z. Kolvani: Po ne që duam të shkëpusim lejen?

Znj. Enjela: Nuk ka problem. Minimumi është 3 muaj. Mund të bëni shtyrje ose shkëputje. Ka diçka tjetër? Ju faleminderit.

SEKRETARE E KËSHILLIT

Jona BOJKO

